VENDIM
Nr. 195, datë 15.3.2017

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NR. 1 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF019228, TË FONDIT TË BESIMIT ME SHUMË DONATORË "REPARIS", NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË RAPORTIMIT FINANCIAR, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 749, DATË 16.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit nr. 1 të marrëveshjes së grantit nr. TF019228, të Fondit të Besimit me Shumë Donatorë "Reparis", ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të përmirësimit të cilësisë së raportimit financiar, të miratuar me vendimin nr. 749, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

1818 H Street N.W.
Washington, D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVAS

31 gusht 2016

Shkëlqesisë së Tij, Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Tiranë, Shqipëri

Lënda: Granti i Fondit të Besimit me Shumë Donatorë "REPARIS" nr. TF019228
Projekti i Përmirësimit të Cilësisë së Raportimit Financiar
Ndryshimi nr. 1 i Marrëveshjes së Grantit

Shkëlqesi:

Ne i referohemi marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Marrësi") dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar ("Banka Botërore") që vepron si administratore për fondet grante të dhëna sipas "Rruga për në Evropë": Programi për Kontabilitetin dhe Fuqizimin Institucional (REPARIS) të datës 11 qershor 2015 dhe në fuqi që nga data 29 shtator 2015 ("Marrëveshja"), për Projektin e Përmirësimit të Cilësisë së Raportimit Financiar ("Projekti").

Në vijim të diskutimeve tona më të fundit, Banka Botërore propozon të amendojë Marrëveshjen për të shtyrë datën e mbylljes si vijon:

Seksioni 3.03 i Marrëveshjes këtu fshihet dhe zëvendësohet tërësisht duke u lexuar si vijon:

"3.03. Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e referuar në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është 31 dhjetor 2019."

Të gjitha afatet dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes, me përjashtim sa është amenduar këtu, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem, konfirmoni pranimin tuaj në lidhje me amandamentin e mësipërm duke e nënshkruar dhe vendosur datën në këtë letër, në hapësirën e dhënë më poshtë. Kjo letër amendamenti do të realizohet në dy kopje të njëjta, ku secila prej tyre do të jetë origjinale dhe njëra prej tyre do të kthehet te ne. Dispozitat e përcaktuara në këtë letër amandamenti do të hyjnë në fuqi në datën e njoftimit nga Marrësi për Bankën Botërore në lidhje me përfundimin e procedurave të saj të brendshme.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

Nga (nënshkrimi)

Ellen Goldstein
Drejtore e Vendit për Evropën Juglindore
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

PRANUAR:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga: _____
Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____